



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 28.3.2023

Nr: 212

Ora: 16:50

VENDIM

PËR

NDALIMIN E ZHVILLIMIT TË VEPRIMTARISË ME KARAKTER PUBLIK TË BASHKISË LUSHNJË

Sot më datë 28.3.2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mora në shqyrtim çështjen administrative me:

SUBJEKT: Bashkia Lushnjë

OBJEKTI: Ndalim i zhvillimit të veprimtarisë me karakter publik, të raportuar nga Bashkia Lushnjë

BAZA LIGJORE: Neni 19, pikat 1, shkronja “n” dhe 2, neni 91 dhe 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator, “Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”,

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

KONSTATOJ:

Në datë 25.3.2023, Bashkia Lushnjë ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve veprimtaritë publike të mëposhtme, me objekt:

1. Aktiviteti “Inspektim punimesh, kanali i ujërave të larta, Lushnjë (me media sociale)”, me pjesëmarrës: Taulant Balla, Eriselda Sefa, raportuar më datë 25 mars, për t’u zhvilluar më datë 30 mars.

2. Aktiviteti *“Inspektim punimesh, muri mbajtës, lagja ‘Kongresi’, Lushnjë (me media sociale)”* me pjesëmarrës: Taulant Balla, Eriselda Sefa, raportuar më datë 25 mars për t’u zhvilluar më datë 30 mars.
3. Aktiviteti *“Inspektim punimesh, palestra e shkollës ‘Foto Puka’ Lushnjë (ripublikim, me media sociale)”*, me pjesëmarrës: Taulant Balla, Eriselda Sefa, raportuar më datë 25 mars për t’u zhvilluar më datë 30 mars.
4. Aktiviteti *“Inspektim punimesh, markatë në lagjen ‘Xhevdet Nepravishta’, Lushnjë (me media sociale)”*, me pjesëmarrës: Taulant Balla, Eriselda Sefa, raportuar më datë 25 mars për t’u zhvilluar më datë 30 Mars.
5. Aktiviteti *“Dita Kombëtare e Mjekëve, (takim me mjekë, me media sociale)”*, me pjesëmarrës: Taulant Balla, Eriselda Sefa, Laureta Xhafa, mjekë të Lushnjës, raportuar më datë 25 mars për t’u zhvilluar më datë 30 Mars.

Referuar nenit 92, pikat 1, 2 dhe 4 të Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, parashikohet se institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, janë të detyruara të raportojnë në KQZ të gjitha veprimtaritë me karakter publik që planifikojnë të zhvillojnë në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve.

Në rast se KQZ-ja, kryesisht ose me kërkesë të të tretëve, konstaton nga informacioni, sipas pikës 3 të këtij neni, se veprimtaria mund të përbëjë keqpërdorim të burimeve shtetërore, atëherë ajo urdhëron ndalimin e zhvillimit të saj.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, nga të dhënat e paraqitura në raportim ka konstatuar se, aktivitetet e zhvilluara nga institucioni publik, Bashkia Lushnjë, me pjesëmarrjen e personave partiakë përbëjnë veprimtari të ndaluara, në kuptim të nenit 91 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “n” dhe 2, nenin 92 pika 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, “Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”,

VENDOS:

1. Ndalimin e zhvillimit të 5(pesë) veprimtarive publike, me datë zhvillimi 30 mars 2023, me temë:
 - a) Inspektim punimesh, kanali i ujërave të larta,
 - b) Inspektim punimesh muri mbajtës, lagja 'Kongresi',
 - c) Inspektim punimesh, palestra e shkollës 'Foto Puka' Lushnjë (ripublikim),
 - ç) Inspektim punimesh markat në lagjen 'Xhevdet Nepravishta',
 - d) 30 Marsi 'Dita Kombëtare e Mjekëve'
2. Vendosjen e shënimit "Ndaluar nga KQZ" në ndërfaqen e raportimit.
3. Njoftimin e Autoritetit të Mediave Audiovizive të mos lejojë transmetimin apo pasqyrimin në rubrikat e lajmeve apo ato që mbulojnë fushatën në radio dhe televizione.
4. Ky vendim i njoftohet palëve nëpërmjet postës elektronike.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI